



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 703/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Valdete Qorri kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Valdete Qorri kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA, me shenjën ZL.Anr.703/2017, e datës 09.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Valdete Qorri kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA me datën 09.11.2017, me të cilën thekson se i janë vjedhur votat. Më tej kërkon që të rinumërohen votat në fshatrat: Gllobar, Gllogoc, në shkollën fillore “Rasim Kiqina”, shkollën fillore “Halil Bajraktari”

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi nuk e specifikon se sa vota dyshon që i mungojnë dhe sa pretendon ti posedon. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.703/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.